



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PRESIDENTI

DEKRET

PËR

KTHIMIN E LIGJIT NR. 9046, DATË 03.04.2003 “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË GREQISË PËR NDËRTIMIN E GODINËS SË KOMANDËS DHE MJEDISEVE TË AKOMODIMIT TË PERSONELIT, SI DHE THELLIMIN E KANALIT HYRËS DHE TË BAZËS DETARE TË BISHTIT TË PALLËS”


Në mbështetje të neneve 85 dhe 93 të Kushtetutës,

Dekretoj

Kthimin për rishqyrtim edhe një herë në Kuvend të ligjit nr. 9046, datë 03.04.2003 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë për ndërtimin e godinës së komandës dhe mjediseve të akomodimit të personelit, si dhe thellimin e kanalit hyrës dhe të basenit të Bishtit të Pallës””.

Nr. i dekretit 3798
Tiranë, më 24.04.2003

PRESIDENTI I REPUBLIKES
ALFRED MOISIU



6

MOTIVIMI I KTHIMIT TË LIGJIT NR. 9046, DATË 3.4.2003
“PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET MINISTRISË SË
MBROTJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË
MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË GREQISË PËR NDËRTIMIN
E GODINËS SË KOMANDËS DHE MJEDISEVE TË AKOMODIMIT TË
PERSONELIT SI DHE THELLIMIN E KANALIT HYRËS DHE TË BASENIT TË
BAZËS DETARE TË BISHTIT TË PALLËS”

Të nderuar deputetë!

Më datë 7.4.2003 më ka ardhur për t’u dekretuar ligji nr. 9046, date 3.4.2003, i cili ka ratifikuar në bazë të nenit 121 të Kushtetutës, marrëveshjen e lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë “Për ndërtimin e godinës së komandës dhe mjediseve të akomodimit të personelit si dhe thellimin e kanalit hyrës dhe të basenit të Bazës Detare të Bisht Pallës”.

Bazuar në nenin 85, paragrafi 1 i Kushtetutës, kthej ligjin për rishqyrtim për shkaqet në vijim:

1 - Gjej mospërputhje mes qëllimit të marrëveshjes (të përcaktuar në nenin 1) dhe kohëzgjatjes dhe përfundimit të saj (të përcaktuar në nenin 16). Sipas marrëveshjes, qëllimi i saj është fillimi dhe përfundimi i ndërtimit të godinës së komandës dhe mjediseve të tjera të bazës së Bisht Pallës dhe thellimi i kanalit hyrës dhe basenit të bazës. Ndërsa, formula e ndjekur për kohëzgjatjen e marrëveshjes është ajo standarte, d.m.th. marrëveshja do të jetë në fuqi për një periudhë kohore prej 5 vjetësh, me një rinovim automatikisht të saj për një vit kohë, nëse palët nuk do të vendosin ndryshe. Në vazhdim, marrëveshja përcakton edhe rregullime lidhur me përdorimin e bazës shqiptare nga flota detare greke si dhe elemente të tjera që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e saj në kuadrin e operacioneve dy ose shumë palëshe. Nisur nga sa sipër, ka vend të saktësohet përputhshmëria midis nenit 1 dhe nenit 16, pra, nëse afati 5-vjeçar është afati i përcaktuar për përfundimin e punimeve, apo ky afat është më i shkurtër, ndërsa afati 5-vjeçar me të drejtën e rinovimit për një vit, nënkupton edhe afatin e përdorimit të bazës në kuadër të marrëdhënieve dy ose më shumë palëshe.

2 - Neni 11 paraqet dy probleme, të cilat meritojnë vëmendjen tuaj për rishqyrtim të ligjit. Çështjet janë:

Së pari, marrëveshja mundëson Flotën Shqiptare dhe atë Greke “të lidhin protokoll bashkëpunimi për të përcaktuar detajet për prezencën e anijeve të Flotës Greke në bazë”. Gjykoj se ky paragraf lë shteg për interpretime të ndryshme. Ai

mund të interpretohet në mënyrë të zgjeruar duke dalë jashtë objektit të marrëveshjes. Paragrafi i dytë i këtij neni i ka të përcaktuara rastet se kur, Flota Greke, do të ketë të drejtën të vizitojë bazën e Bisht Pallës. Dhe pikërisht anijet e flotës greke do të vizitojnë bazën vetëm në tre raste:

- në rastet e trainimeve operacionale,
- në rastet e marrëdhënieve dypalëshe,
- në rastet e operacioneve Pfp/CRO ose NATO.

Në të tre këto raste, anijet e flotës greke do të hyjnë në Shqipëri dhe në Bisht Pallë në bazë të marrëveshjeve respektive dhe nuk del nevoja për një protokoll të veçantë bashkëpunimi. Në rast se ky paragraf zbatohet, atëherë “një protokoll i veçantë bashkëpunimi” do të ishte në kapërcim të objektit të marrëveshjes.

Së dyti, ky paragraf i jep të drejtë flotës shqiptare dhe asaj greke të lidhin këtë protokoll të veçantë bashkëpunimi. Lidhja e të tilla protokolleve apo marrëveshjeve ndërkombëtare nuk i takon asnjë subjekti tjetër veç atyre të njohura në Kushtetutë. Flota Shqiptare nuk ka tagër kushtetues për të lidhur marrëveshje apo protokolle bashkëpunimi me jashtë.


Veç sa më sipër, në rastin eventual të rishqyrtimit të ligjit për shkaqet e mësipërme, jo të një rëndësie me to, por që vleresoj se lipsët të jenë në vëmendjen tuaj, janë edhe dy momente të tjera që lidhen me paragrafin 2 të nenit 11 të marrëveshjes. Dhe konkretisht:

a - Paragrafi 2 i nenit 11 bën fjalë për “anije të flotës greke të cilat do të vizitojnë zonën në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe apo në ndonjë kuadër tjetër”. Por, marrëveshja nuk përcakton se për çfarë flote bëhet fjalë (ushtarake, tregëtare, etj).

b - Gjithashtu në paragrafin 2 të nenit 11 përcaktohet se “anijet e flotës greke do të kenë të drejtë të ankorohen në bazë për të kryer riparime lehtësuese”. Gjykoj se duhet saktësuar se cilat do të quhen riparime lehtësuese, pasi, “lehtësuese” është një term i interpretueshëm, që ka nevojë për saktësime të mëtejshme.

Duke shpresuar në mirëkuptimin Tuaj,

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
ALFRED MOISIU

The image shows the official seal of the President of the Republic of Albania, which is circular and contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRIE" and "PRESIDENTI". To the right of the seal is a handwritten signature in black ink.